



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 155, datë 22.12.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1,4,5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar; Raportit me nr. 765/39 prot., datë 20.12.2022 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1,4,5, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26

nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas anekseve përkatëse, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- a. Aneksi 1 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.1”.
 - b. Aneksi 2 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4”.
 - c. Aneksi 3 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5”.
 - d. Aneksi 4 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull”.
 - e. Aneksi 5 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth”.
 - f. Aneksi 6 : “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Katund i Ri”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 27.12.2022

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.1

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	66662	FATMIR	XHEVIT	SHEHU	7	PRISHJE	PO
2	26662	AHMET	OSMAN	KONÇI	2	PRISHJE	PO



ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	2574	SHPETIM	KARAFIL	HOXHA	6	RIFORCIM	PO
2	73643	YMER	GAFUR	TRESHNIKU	5	PRISHJE	PO
3	51403	ARJAN	GJOVALIN	KABALI	4	RIFORCIM	PO



ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	38057	MENTOR	PERTEF	TARAJ	2	RIFORCIM	PO
2	71390	FERDINANT	XHEVDET	XHINDOLI	4	PRISHJE	PO



ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	35042	RAIMOND	IBRAHIM	BARDHI	1	PRISHJE	PO



ANEKSI 5. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	12017	ARBEN	ALI	ALIU	4	PRISHJE	PO
2	52341	LADIMIR	SHEFKI	SULKO	4	RIFORCIM	PO



ANEKSI 6. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	18411	RAHMAN	RAMAZAN	MYFTARI	4	PRISHJE	PO
2	16257	SHYQYRI	BEQIR	RUCI	9	PRISHJE	PO






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 954 prot.
P

Durrës, më 06.01.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.155 datë 22.12.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr 1,4,5 Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Bashkia Durrës që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

